

RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT

JANAR- DHJETOR 2023

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

1. PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Informacion buxhetor i agreguar
- Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti
- Performanca e buxhetit në nivelin e programit
 - Performanca financiare e programit buxhetor
 - Performanca jo- financiare e programit buxhetor
 - Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor
- Projektet kapitale
- Ndryshimet në buxhet
- Përfundime

2. Hyrje

Në zbatim të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”*, paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të realizimit të fondeve buxhetore të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit për vitin 2023 si më poshtë vijon:

Programet buxhetore të Ministrisë, në përmbushje të politikave të tyre, kanë kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 84/ 2022 *“Për buxhetin e vitit 2023”*, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”*.

EMP-të me në krye DEMP kanë realizuar monitorimin e performancës së programeve, konkretisht të politikës së programeve, objektivave, treguesve të performancës, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në funksion të tyre për të gjithë artikujt përkatës.

Gjatë vitit 2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në kuadër të monitorimit të buxhetit ka përgatitur në fund të çdo muaji evidencën e shpenzimeve korrente dhe kapitale, të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin faktik të thesarit sipas SIFQ.

Ky raport përmban një analizë të detajuar për periudhën janar- dhjetor 2023, lidhur me arritjen e treguesve dhe objektivave të parashikuara në programet buxhetore si më poshtë:

1. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”
2. “Mbrojtja e Mjedisit”
3. “Administrimi i Pyjeve”
4. “Zhvillimi i Turizmit”
5. “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” (fillon aktivitetin pas miratimit të strukturave përkatëse)

Ky i fundit (06220) është një programi i ri, i cili i është shtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 14200 prot., datë 2.8.2023 *“Dërgohen tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”*. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 19.07.2023 *“Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”*, në programin e Menaxhimit të Mbetjeve Urbane janë akorduar fonde në shpenzimet kapitale (financim i brendshëm dhe financim i huaj) për vitet 2024-2026, të cilat aktualisht paraqiten si fonde të ngrira deri në momentin e krijimit të strukturave përkatëse për menaxhimin, detajimin dhe përdorimin e tyre.

Bashkëlidhur këtij raporti gjenden anekset e plotësuara të specifikuara në Udhëzim. Të dhënat janë rakorduar me planin e buxhetit dhe realizimin faktik të thesarit sipas SIFQ-it për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale në buxhetin e miratuar për vitin 2023.

Buxheti i vitit 2023 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është çelur sipas shkresave të poshtë cituara dhe për periudhën janar- dhjetor ka patur ndryshime:

- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 23774/44 prot., datë 20.01.2023 “*Dërgohet detajimi i shpenzimeve korrente për vitet 2023-2025*”, vlera në total për MTM është 1.493.500.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 3107/1 prot., datë 21.02.2023 “*Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023*”, sipas Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023*”, vlera në total për MTM është 1.900.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 2919/1 prot., datë 28.02.2023 “*Dërgohet detajimi i buxhetit 2023-2025 për shpenzimet kapitale*”, vlera në total për MTM për vitin 2023 është 809.100.000 lekë;
- VKM nr. 293, datë 17.05.2023 “*Rishpërndarje fondesh për buxhetin e miratuar 2023 ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”, është shtuar llogaria 604 me 45.000.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 12759 prot., datë 11.07.2023 “*Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2023*”, është shtuar llogaria 600 dhe 601 me 143.793.000 lekë;
- Akti Normativ nr. 5, datë 18.10.2023 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023*”, është shtuar llogaria e investimeve kapitale me 285.000.000 lekë dhe është shtuar llogaria e shpenzimeve operative 602 me 37.000.000 lekë;
- Akti Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, të ndryshuar*”, është pakësuar llogaria e investimeve kapitale me 111.300.000 lekë dhe janë pakësuar shpenzimet operative në vlerën 81.090.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 748 prot., datë 15.01.2024 në zbatim të VKM-së nr. 795, datë 28.12.2023 “*Për shpërblimin e punonjësve të Qeverisjes Qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian*”, është shtuar llogaria e pagave me 4.657.000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 875/1 prot., 15.01. 2024 datë në zbatim të VKM-së nr. 834, datë 28.12.2023 “*Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë”, të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, të miratuar për disa institucione*”, është shtuar llogaria e pagave me 1.460.000 lekë.

3. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Realizimi i Buxhetit të MTM sipas Programeve Buxhetore

Në 000 lekë

Buxheti MTM	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2023	Realizimi Dhjetor 2023	Realizimi në %
Planifikim, Menaxhim & Administrim	210.590	15.970	226.560	211.753	93%
Administrimi i Pyjeve	526.050	(552.928)	473.122	454.487	96%
Zhvillimi i Turizmit	595.060	371.843	966.903	930.210	96%
Mbrojtja e Mjedisit	580.900	(8.465)	572.435	523.604	91%
TOTALI	1.912.600	326.420	2.239.020	2.120.054	95%

Realizimi i Buxhetit të MTM sipas Llogarive Ekonomike

Në 000 lekë

	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2023	Realizimi Dhjetor 2023	Realizimi në %
Llogaria 600-601	848.590	22.720	871.310	860.929	99%
Llogaria 602	535.238	87.500	622.738	564.933	91%
Llogaria 604	88.000	40.600	128.600	124.596	97%
Llogaria 605	20.000	0	20.000	10.125	51%
Llogaria 606	1.672	1.900	3.572	1.930	54%
Llogaria 230-231 (financim i brendshëm)	419.100	173.700	592.800	557.543	94%
TOTALI	1.912.600	326.420	2.239.020	2.120.054	95%

Realizimi i Buxhetit të MTM sipas burimit të financimit

Në 000 lekë

	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2023	Realizimi Dhjetor 2023	Realizimi në %
Buxheti i Shtetit- Kapitull 1&3&4	1.912.600	326.420	2.239.020	2.120.054	95%
Financim i Huaj- Kapitull 2	390.000	0	390.000	50.164	13%
Shpenzimet nga te ardhura jashte limiti-Kapitull 6	0	0	0	18.836	%
TOTALI	2.302.600	326.420	2.629.020	2.189.054	83%

- **Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600-601)** për vitin 2023 janë realizuar në masën 99% kundrejt fondeve totale të planifikuara.
- **Shpenzimet korrente (602-606)** për vitin 2023 janë realizuar në masën 90% kundrejt fondeve totale të planifikuara.
- **Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231)** për vitin 2023 janë realizuar në masën 94% kundrejt fondeve totale të planifikuara.
- **Shpenzimet kapitale me financim të huaj (230-231)** për vitin 2023 janë realizuar në masën 13% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara, për shkak se dy nga projektet me buxhetin më të lartë të planifikuar i. “*Ekonomia qarkulluese IPA 3*” me vlerë 182.000.000 dhe proekti ii. “*Clean and Resilient Enviorenment for Blue Sea Project CARE4BLUESEA*” me vlerë 100.000.000 lekë kanë qënë në fazën fillestare (inception) dhe nuk kanë patur shpenzime për t’u raportuar.
- **Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit (Kap. 6)** për vitin 2023 paraqiten në vlerën 18.836.027 lekë, ku përfshihen shpenzimet e realizuara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24.12.2020 “*Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen nga zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre*” si edhe grantet e UNEP të Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 “*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetor*” Ministria mbledh të ardhura për llogari të Thesarit të Shtetit për dhënie e lejeve mjedisore, liçencave, autorizimeve, tarifave vjetore, guida turistike, transit dhe eksport mbetje jo të rrezikshme. Në ndryshim nga Aparati dhe institucionet e tjera të varësisë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), i përdor të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e miratuara për zonat e mbrojtura.

Alokimet janar- dhjetor 2023

Lidhur me ndryshimet në buxhet gjatë periudhës raportuese, në total janë realizuar 7 transferime fondesh, nga të cilat 6 kanë rezultuar në rritje të buxhetit të ministrisë dhe 1 (Akti Normativ nr. 5) ka rezultuar në pakësim të fondeve, si më poshtë:

- Miratim i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 3107/1 prot., datë 21.02.2023 *“Dërgohet detajimi i fondit të vecantë për vitin 2023”*, sipas Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19. 01 .2023 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”* vlera në total për MTM është 1.900.000 lekë (çelja fillestare për fondin e vecantë);
- VKM nr. 293, datë 17.05.2023 *“Rishpërnadrje fondesh për buxhetin e miratuar 2023 ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*, është shtuar llogaria 604 me 45.000.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 12759 prot., datë 11.07.2023 *“Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2023”*, është shtuar llogaria 600 dhe 601 me 143.793.000 lekë;
- Akti Normativ nr. 5, datë 18.10.2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”*, është shtuar llogaria e investimeve kapitale me 285.000.000 lekë dhe është shtuar llogaria e shpenzimeve operative 602 me 37.000.000 lekë;
- Akti Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, të ndryshuar”*, është pakësuar llogaria e investimeve kapitale me 111.300.000 lekë dhe janë pakësuar shpenzimet operative në vlerën 81.090.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 748 prot., datë 15.01.2024 në zbatim të VKM-së nr. 795, datë 28.12.2023 *“Për shpërblimin e punonjësve të Qeverisjes Qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”*, është shtuar llogaria e pagave me 4.657.000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 875/1 prot., 15.01. 2024 datë në zbatim të VKM-së nr. 834, datë 28.12.2023 *“Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2021 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë”, të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, të miratuar për disa institucione”*, është shtuar llogaria e pagave me 1.460.000 lekë.

Pjesa tjetër e rialokimeve (12 raste) është realizuar brenda tavaneve të miratuara të ministrisë për shpenzimeve korrente dhe kapitale.

Referuar numrit të punonjësve të ministrisë, konform strukturave të miratuara, për vitin 2023 janë planifikuar 866 punonjës, ndërsa numri faktik në muajin dhjetor është 710 punonjës. Struktura e Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.185, datë 15.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”*. Institucionet e varësisë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe 4 Agjencitë Rajonale, bazuar në VKM-në nr. 568, datë 17.7.2020 të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”*, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 15.11.2022 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë*

Kombëtare të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 188, datë 15.11.2022 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 26, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, të cilës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 186, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, janë organizuar 4 Agjenci Rajonale të Bregdetit në Lezhë, Durrës, Vlorë, Sarandë; Agjencia Kombëtare e Turizmit bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 122, datë 31.07.2018 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 175, datë 09.12.2016” të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Turizmit”; Agjencia Kombëtare e Pyjeve me VKM nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 192, datë 18.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.

4. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Treguesit e performancës me bazë gjinore për vitin 2023 paraqiten sipas tabelës së më poshtme:

Tabela me Aktivitetet Turistike ku përfaqësuese ligjore janë gra:

Nr.	AKTIVITETI	TOTALI	GRA	GRA në %
1	Struktura akomoduese /Aplikime	1902	490	25.7%
2	Agroturizëm	63	14	22.2%
3	Udhërrëfyes	495	141	28.8%
4	Operator Turistik	222	73	32.8%
5	Operator të Turizmit Detar	107	10	9.3%

5. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Ky program ka si objektiv rritjen, forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese për një planifikim, menaxhim dhe administrim të politikave dhe strategjive në fushën e mjedisit, pyjeve, turizmit si dhe koordinimi i punës me të gjitha drejtoritë e politikave për kontrollin dhe zbatimin e tyre; trajnimi si një mjet strategjik për rritjen e burimeve njerëzore; hartimi dhe rritja e kontrollit mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve financiare në të gjithë strukturën e MTM-së dhe institucionet e varësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat në kuadër të procesit të integritetit. Qëllimi i politikës së programit është përmirësimi i strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore për të krijuar një staf permanent dhe sa më të qëndrueshëm për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Gjatë periudhës të vitit 2023, për këtë program janë realizuar produktet dhe treguesit e performancës së synuar.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar-dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art.	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2023	Dhjetor 2023	
	Planifikim, Menaxhim & Administrim	210.590	15.970	226.560	211.753	93%
600	Pagat	83.490	12.350	95.840	95.220	99%
601	Sigurime Shogërore	13.600	3.300	16.900	16.850	100%
602	Shpenz. Operative	88.900	0	88.900	86.380	97%
605	Transferta korrente të huaja	20.000	0	20.000	10.124	51%
606	Transferte tek individët	1.600	320	1.920	979	51%
18AV402	Pajisje TIK	2.000	0	2.000	1.422	71%
M260001	Orendi dhe pajisje	1.000	0	1.000	779	78%

Në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” për vitin 2023, shpenzimet korrente dhe kapitale janë realizuar në nivelin 93% kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “Akte ligjore dhe nënligjore” është realizuar në masën 94% gjatë vitit 2023, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Në shpenzimet kapitale të planifikuara (llogaria 231), projekti “Pajisje TIK” është një procedurë që zhvillohet nga AKSHI dhe është realizuar në masën 71% ndaj fondeve të planifikuara. Projekti “Orendi dhe pajisje” është realizuar në masën 78% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2023.

2. Programi “Mbrotjtja e Mjedisit”

Programi i Mbrotjtjes së Mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, nëpërmjet garantimit të përputhshmërisë së veprimtarive me ndikim në mjedis me kushtet e lejeve mjedisore dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor, përmirësimin të cilësisë së ajrit në zonat kryesore urbane; menaxhimit të integruar të mbetjeve, parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale, përsheptimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjes së gazrave me efekt serë; ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, biodiversitetit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura.

Monitorimi i këtij programi kryhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave nëpërmjet produkteve dhe indikatorëve të përcaktuar për secilin prej tyre. Analiza vlerësuese tregon se përgjithësisht ato janë në përputhje me afatet dhe standartet e parashikuara në PBA 2023-2025.

Puna për realizimin e programit “Mbrotjtja e Mjedisit” është përqëndruar në tre shtylla kryesore, që lidhen respektivisht me objektivat e përcaktuar në dokumentin e PBA-së:

1. Hartimi i legjislacionit për transpozimin e aquis së mjedisit dhe aquis të ndryshimeve klimatike;
2. Zbatimi i legjislacionit që lidhet me:
 - a) Monitorimin e mjedisit nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për fushën e cilësisë së ajrit, zhurmave, cilësisë së ujërave, mbetjeve, biodiversitetit;
 - b) Shqyrtimin dhe miratimin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në mjedis dhe lejeve mjedisore;
3. Inspektime kontrolli për aktivitetet industriale dhe veprimtari prodhuese, lidhur me shkarkimet në ajër, menaxhimin e mbetjeve industriale, urbane si dhe zhurmave.

Objektivi i parë lidhet me sigurimin e mbrojtjes së mjedisit në një nivel të lartë, janë hartuar akte ligjore dhe nënligjore që transpozojnë direktiva, rregullore dhe vendime të BE për fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike.

Objektivi i dytë lidhet me përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj mjedisit dhe klimës. Janë hartuar raporte kombëtare për zbatimin e detyrimeve kombëtare sipas kërkesave nga Sekretariatet e Konventave për konventat që mbulohen nga Drejtoria e Mjedisit, Ndryshimeve Klimatike dhe Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura; në kuadër të integritetit evropian janë përgatitur raportimet në kuadër të takimeve të nënkomiteteve BE-Shqipëri për mjedisin dhe Komitetin e Stabilizim Asociimit.

Objektivi i tretë lidhet me kryerjen e raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit, zhurmave e ujërave urbane, të cilësisë së ujërave në lumenj, liqene, dete dhe laguna, të monitorimit të treguesve në pyje dhe biodiversitet dhe të treguesve të shkarkimit e transferimit të ndotësve dhe raporti vjetor i gjendjes në mjedis. Janë shqyrtuar dosjet e aplikimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Janë shqyrtuar dosjet e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B. Është bërë raportimi dhe publikimi i aktiviteteve të AKM-së në vijimësi.

Gjatë vitit 2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë ngritur 43 stacione monitorimi për zhurmat urbane në Tiranë, Vlorë, Fier, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Sarandë, Pogradec, Shkodër, Kukës dhe Lezhë. Lidhur me monitorimin e cilësisë së ujërave:

- janë ngritur 38 stacione në lumenjtë kryesorë të vendit;
- 3 stacione për tributarët e liqenit të Ohrit;
- 10 stacione në liqenet natyralë;
- 20 stacione në ujërat e zonës bregdetare;
- 4 stacione lagunore në Lagunën e Karavastasë dhe Nartë.

Mbrojtja e mjedisit është programi buxhetor i ndarë në tre produkte:

- Raporte monitorimi- nga 2400 raporte të planifikuara, janë realizuar 7143 raporte. Parashikimi për këtë produkt është tejkaluar me 4743 raporte.
- Dosje të shqyrtuara për përfitimin e lejeve të mjedisit- për vitin 2023 janë parashikuar për shqyrtim 1300 dosje dhe janë shqyrtuar 825 aplikime për leje Mjedisit të tipit A, B dhe III.2.B, nga 825 aplikime të ardhura nga subjektet në sistem nga QKB-ja. Numri i dosjeve është në varësi të aplikimeve që bëjnë subjektet e interesuara. Nga analiza rezulton se janë shqyrtuar 100% e aplikimeve.

- Inspektive të kryera- realizimi për këtë produkt ka qënë në rritje 4 mujin e tretë duke qënë se në fillim vitit nuk janë kryer inspektive. Për këtë produkt janë parashikuar që do të realizohen 966 inspektive gjithsej gjatë 2023 dhe rezulton se janë realizuar 495 inspektive ose 47.5%. Kjo masë realizimi ka ardhur si rezultat i përfshirjes në procesin e ristrukturimit të institucionit.

Transparencë në procesin e Lejeve Mjedisore

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit e ka bërë pjesë funksionale të punës së saj konsultimin me publikun;
- Kriteret për aplikim janë të gjitha online dhe të aksesueshme për aplikuesit;
- Subjektet kontrollojnë nëpërmjet QKL të gjitha procedurat, të cilat janë online;
- Çdo leje mjedisore publikohet online dhe publikohen për 20 ditë të gjitha projektet e detajuara me vendndodhjen, qëllimin e detajet teknike përkatëse.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar- dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2023	Dhjetor 2023	
	Mbrojtja e Mjedisit	580.900	(8.465)	572.435	523.604	91%
600	Pagat	279.000	(12.695)	266.305	263.265	99%
601	Sigurime Shoqërore	46.500	(4.290)	42.210	41.709	99%
602	Shpenzime Operative	125.400	(15.000)	110.400	100.090	91%
604	Të tjera Transfera Brendshme	10.000	15.000	25.000	21.754	87%
606	Transferim tek individët	0	520,3	520	520	100%

18BF301	Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese	50.160	0	50.160	50.109	99%
18BG705	Fire Prep-TVSH	1.000	(700)	300	0	0%
18BG705	Fire Prep-kosto lokale	5.000	0	5.000	0	0%
18BH005	ËBC-RRI-NET (Horizont 2020)- TVSH	200	0	200	0	0%
18BH202	Menaxhimi i kimikateve dhe mbetjeve farmaceutike ne Shqiperi (Str. Sound.Chem)-TVSH	700	0	700	0	0%
M260379	Mbetjet ne kuader te ndryshimeve klimatike-GIZ-TVSH	30.000	(7.300)	22.700	7.776	34%
M260248	Projekti i Zones Biosferike te Parkut Kombetar te Prespes-TVSH	0	15.300	15.300	14.602	95%
18BH301	SANE 27 -Raporte perfomance te hartuara - TVSH	7.488	0	7.488	301	4%
M260401	TVSH-Pershtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushen e menaxhimit nderkufitar te riskut te permbytjeve ne Ballkanin Perendimor - GIZ	75	0	75	75	100%
18BF502	Rikonstruksion i Godines se AKM	24.000	0	24.000	22.795	95%
18BG704	Kosto Lokale- IPA 3 ekonomia qarkulluese	1.377	0	1.377	0	0%
18BH101	Sistemi i ngritur për parandalimin e mbetjeve detare	0	700	700	609	87%

Në programin “Mbrotjtja e Mjedisit” për vitin 2023 shpenzimet korrente (600-606) janë realizuar në nivelin 96% kundrejt fondeve totale vjetore të planifikuara. Shpenzimet kapitale (230-231) me financim të brendshëm janë realizuar në nivelin 75% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2023.

Produkti *“Akte ligjore dhe nënligjore, dokumenta strategjike”* është realizuar në masën 76% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;

Produkti *“Inspektime te kryera”* është realizuar në masën 98% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;

Produkti “*Raporte monitorimi*” është realizuar në masën 92% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;

Produkti “*Dosje të shqyrtuara*” është realizuar në masën 99% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;

Produkti “*Projekte të financuara për promovimin e mjedisit*”, është realizuar në masën 100% kundrejt fondeve totale të planifikuara për vitin 2023. Ky është një produkt i ri në llogarinë 604 të apatatit të ministrisë, i çelur gjatë këtij viti nëpërmjet rialokimit të fondeve buxhetore brenda tavaneve të miratuara. Janë realizuar dy projekte 1. “*Check in Fest Tirana*” me subjekt Optima Communication sh.p.k. dhe 2. “*Shtigje të reja turizmi në Luginën e Valbonës*” me subjekt Qendra për Zhvillim Komunitar.

- Lidhur me projektet me financim të brendshëm, investimi “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese*” është realizuar në masën 100%;

- Projekti “*Rikonstruksioni i godinës së AKM-së*” është realizuar në masën 95% ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2023.

❖ Projektet në programin e mjedisit janë të renditura si më poshtë:

- TVSH-ja e projektit “*Fire Prep*” nuk është realizuar pasi subjektet e kontraktuara nuk kanë qënë subjekt i pagesës së tvsh-së; ndërsa fondi i planifikuar për koston lokale nuk është realizuar pasi projekti ka përdorur vlerën e grantit që ka patuar gjendje;
- TVSH-ja e projektit “*ËBC-RRI-NET (Horizont 2020)*” nuk është realizuar pasi subjektet e kontraktuara nuk kanë qënë subjekt i pagesës së tvsh-së;
- TVSH-ja e projektit “*Menaxhimi i kimikateve dhe mbetjeve farmaceutike në Shqipëri (Str.Sound.Chem)*” nuk është realizuar, pasi për projektin nuk janë realizuar aktivitete gjatë vitit 2023;
- TVSH-ja e projektit “*Mbetjet ne kuader te ndryshimeve klimatike-GIZ*” është realizuar në masën 34% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2023;
- TVSH-ja e projektit “*Raporte performace të hartuara SANE 27*” është realizuar në masën 4%, pasi subjektet e kontraktuara nuk kanë qënë subjekt i pagesës së tvsh-së;
- TVSH-ja e projektit “*Përshtatja me ndryshimet Klimaterike në fushën e menaxhimit ndërkuftar të riskut të përmbajtjeve në Ballkanin Perëndimor- GIZ*” është realizuar në masën 100% ndaj fondeve të planifikuara për vitin 2023;

- Kosto lokale e projektit “IPA 3 ekonomia qarkulluese” nuk është realizuar pasi projekti ka qënë në fazën fillestare (inception) dhe nuk kanë patur shpenzimetë realizuara;
- TVSH “Projekti i zonës biosferike të Parkut Kombëtar të Prespës” është realizuar në masën 95% ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2023.

3. Programi “Administrimi i Pyjeve”

Programi i Administrimit të Pyjeve përfshin hartimin e politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve, duke promovuar zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, koordinimin në nivel qendror, rajonal dhe lokal të praktikave më të mira në drejtim të menaxhimit të burimeve natyrore duke rritur eficiencën në përdorimin e tyre, përdorimin e metodave dhe mjeteve miqësore me mjedisin në planet operationale të zbatimit. Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin pyjor dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve të personelit pyjor dhe administrativ lokal, harmonizimi ligjor e nënligjor, bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e ruajtjen e biodiversitetit.

Monitorimi i këtij programi kryhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave nëpërmjet produkteve dhe indikatorëve të përcaktuar për secilin prej tyre. Analiza vlerësuese tregon se përgjithësisht ato janë në përputhje me afatet dhe standartet e parashikuara në PBA 2023-2025.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar- dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti progresiv	Realizimi në%
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2023	Dhjetor 2023	
	Administrimi i Pyjeve	526.050	(52.928)	473.122	454.487	96%
600	Pagat	253.100	14.362	267.462	266.464	100%
601	Sigurime Shoqërore	42.100	2.150	44.250	44.221	100%
602	Shpenzime Operative	72.178	41.000	113.178	98.042	87%
606	Transferim tek individët	72	860	932	351	38%

18BE611	Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza	102.900	(102.900)	0	0	%
18BE604	Blerje Fidane	1.350	0	1.350	1.350	100%
18BE614	Hartim projekti “Shtigjet ne rrjetin e zonave te mbrojtura”	16.350	0	16.350	15.720	96%
18BE615	“Qendra multifunkionale ne Luginen e Vjoses”	20.000	(8.400)	11.600	11.193	97%
18BE613	Studim mbi rendesine e ekosistemeve te Lagunave	17.000	0	17.000	16.580	98%
18BE502	JICA-Tvsh	1.000	0	1.000	433	57%

Në programin “Administrimi i Pyjeve” shpenzimet korrente (600-606) janë realizuar në nivelin 96% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2023.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231) janë realizuar në masën 96% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2023.

Produkti “*Raporte monitorimi në Zonat e Mbrojtura*” është realizuar në masën 100% gjatë vitit 2023, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “*Objekte të administruara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura*” është realizuar në masën 85% gjatë vitit 2023, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “*Inventarizim dhe kadastër e kryer*” është realizuar në masën 93% gjatë vitit 2023, kundrejt fondeve totale të planifikuara.

Produkti “*Plane menaxhimi për pyjet*” është realizuar në masën 95% gjatë vitit 2023, kundrejt fondeve të totale të planifikuara.

❖ Projektet e programit Administrimi i Pyjeve paraqiten si më poshtë:

- Projekti “*Blerje Fidanë*” është realizuar dhe likuiduar 100%, paguar nga fondet e veta të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Projekti “*Hartim projekti “Shtigjet në rrjetin e zonave të mbrojtura*” është realizuar në masën 96% ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;
- Projekti “*Qendra multifunkionale në Luginën e Vjosës*” është realizuar në masën 97% ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;
- Projekti “*Studim mbi rëndësinë e ekosistemeve të Lagunave*” është realizuar në masën 98% ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2023;
- TVSH-ja e projektit “*JICA*” është realizuar në masën 57% ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2023.
- Projekti “*Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza*” është pakësuar sipas Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023, të ndryshuar*”.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve: Për periudhën Janar –Dhjetor 2023 ka realizuar objektivat e politikës si më poshtë vijon:

1. Monitorimi i rrjetit të burimeve gjenetike pyjeore në popullatat e Ahut dhe Mështenkës në Bashkitë ku janë të ngritura rrjeti i RNI;
2. Monitorimi i gjendjes shëndetësore dhe vitalitetit në pyje në 61 Bashkitë e vendit;
3. Monitorimi i gjendjes së ekzemplarëve të llojeve të drurëve pyjorë dhe BMET të kërcënuar. Matja e treguesëve, kontrolli i numrit të ekzemplarëve, përshkrimi i gjendjes vegetataive, gjendjes fitosanitare dhe plotësimi i formularëve përkatës;
4. Trajtime të stafeve të 61 Bashkive në shkallë vendi;
5. Botimi i dokumentacioneve teknike dhe raporti i gjendjes së pyjeve;
6. Vlerësimi i performancës në sektorin e pyjeve, vlerësimin e gjendjes së pyjeve, impaktit të sektorit përmes ndjekjes së zbatimit të politikave (DPP), strategjive dhe programeve kombëtare dhe trajnimet me stafet e personelit të pyjeve pranë NJ.V.V.

Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/P roduktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardh es	Niveli i planifiku ar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te
Objektivi 1.1	Monitorimi i rrjetit te burimeve gjenetike pyjore ne popullatat e Ahut dhe Mështeknës ne Bashkite ku jane te ngritura rrjeti i RNI;	Pergatitja e raportit pjesor mbi gjendjen e pyjeve sipas tregueseve te monitorimit; 1.Komponenti, monitorimi i rrjetit te burimeve gjenetike pyjore ne popullatat e Ahut dhe fletorve te tjere ne Bashkite, ku jane te ngritura rrjeti i monitorimit te ketyre llojeve.	1. Vezhgimi i gjendjes se burimeve gjenetike pyjore (RNI) ne popullatat e Ahut dhe fletorve te tjere		255	255	255	100%
			2. Plotesimi i skedineve pershkruese per cdo grumbull pyjor.					
			3. Kryerja e matjeve te drureve dhe hedhja e te dhenave ne skedat perkatese sipas metodologjise se		30	30	30	100%
			Plotesimi, perpunimi dhe regjistrimi i bazes te dhenave dhe hartografise sipas RNI per cdo bashki.		60	60	60	100%
			Trajnimi i specialisteve te menaxhimit prane Njesive te Vetqeverisjes Vendore mbi metodologjine e matjes se tregueseve sasiore.		20	20	20	100%
			Shuma I		365	365	365	100%
Objektivi 1.2	Monitorimi i gjendjes shendetesore dhe vitalitetit ne pyje. ne 61 Bashkite e vendit	Pergatitja e raportit pjesor mbi gjendjen eshendetesore te fondit pyjor sipas tregueseve te monitorimit, komponenti; 1. Monitorimi i gjendjes shendetesore dhe vitalitetit ne pyje. ne 61 Bashkite e vendit.	Monitorim i gjendjes shendetesore te pyjore ne siperfaqet prove sipas llojeve. Vezhgimi i rrjetit, matja dhe grumbullimi i te dhenave pershkruese me personat e kontaktit. Kryerja e matjeve sipas metodes se punes dhe		510	510	510	100%
			Trajnimi i specialisteve te menaxhimit te Njesive te Qeverisjes Vendore		30	30	30	100%
